



MINIMUMI I DINJITETIT EKONOMIK TË SHQIPTARËVE!



RAPORT MONITORIMI

Nentor - Janar 2021

- Ekonomia -

AUTOR

Ilda Methasani

QENDRESA
QYTETARE



NED

www.qeverisja.qg.com.al

Hyrje

Cfarë kuptojmë me “Minimum Jetik”?	4
Historiku i përlogaritjes së Minimumit Jetik në Shqipëri	5
Situata aktuale e varfërisë në Shqipëri	10
Politikat ekzistuese për mbrojtjen sociale	12

→ HYRJE

Varfëria është një fenomen i përhapur në të gjithë botën dhe kudo bëhen përpjekje të shumta për të vlerësuar numrin e individëve të cilët konsiderohen të varfër. Nga përvoja e vendeve të tjera, për të matur nivelin e varfërisë përdoren tregues me emërtime të ndryshëm si "niveli zyrtar i varfërisë", "minimumi i ekzistencës", "pragu i varfërisë", "minimumi jetik", "standardet minimale sociale" etj.

Në Shqipëri, minimumi jetik përkufizohet si niveli i të ardhurave, i cili garanton që konsumi të përmbushë kërkesat minimale të qenieve njerëzore në aspektin e nevojave fizike dhe sociale. Në trajtimin e nocionit të minimumit jetik, përkufizimet e dhëna janë të shumta duke përfshirë si ato ndërkombëtare (ILO, FAO) dhe kombëtare (Kodi Penal, Fjalori Enciklopedik Shqiptar). Sipas këtij treguesi konsiderohet si "i varfër" çdo individ i cili ndodhet "nën nivelin e minimumit jetik".

Kur flasim për minimumin jetik, flasim për varfërinë dhe jo perceptimin e një varfërie relative por varfërie absolute, pamundësia për të arritur minimalisht një konsum të denjë! Varfëria nuk është vetëm konsum i nevojave bazë për ushqim, nuk është privim monetar apo material, varfëria është privim i dinjitetit njerëzor për të pasur shanse të barabarta në jetë. Në këtë kuptim varfëria është një thirrje e fortë për ndryshim rrënjësor të sistemit dhe elitës politike. Varfëria e lartë krijon rreth vizioz në shumë aspekte ekonomike dhe sociale. Duhet të pranojmë që të varfërit janë totalisht të varur nga sistemi, ata nuk kanë potencial për të ndryshuar sistemin dhe kjo gjë e bën edhe më të vështirë trajtimin e varfërisë.

Sipas Legjislacionit në fuqi, por edhe sipas Konventave ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, Qeveria e Shqipërisë, institucionet publike, agjencitë kombëtare, kanë për detyrë përmirësimin e kushteve të jetesës dhe sigurimin e kushteve minimale të jetesës duke mbrojtur qytetarët e këtij vendi nga varfëria në kategori të ndryshme të popullsisë në vend.

Një nga parimet e **Axhendës së Kombeve të Bashkuara 2030** është progresi drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke ju kushtuar

vëmendje të veçantë individëve dhe familjeve të varfëra¹. Qeveria shqiptare, në këtë kuadër dhe në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 dhe Dokumentin Politik për Përfshirjen Sociale 2016-2020, ka nisur një reformë të sistemit të mbrojtjes shoqërore duke investuar në hartimin e një legjislacioni të ri në këtë fushë dhe ndërtimin e mekanizmave për të siguruar një sistem efektiv të mbrojtjes sociale.

Të dhënat tregojnë që megjithëse varfëria relative ka ardhur në ulje të pakonsiderueshme nga 23.7 (në vitet 2017-2018²) në 23.4 në vitin 2018, përqindja e popullatës që janë në rrezik varfërie ose jetojnë me të ardhura shumë të ulëta është 49%, që do të thotë se pothuajse gjysma e popullsisë jetojnë në kushte shumë të vështira ekonomike.

➔ Cfarë kuptojmë me “Minimum Jetik”?

Minimumi jetik është shuma monetare e një sërë produktesh ushqimore të përshtatshme për të siguruar funksionimin normal të trupit të njeriut dhe ruajtjen e shëndetit, plus një numër minimal artikujsh jo-ushqimorë dhe një numër minimal shërbimesh të nevojshme për të përmbushur nevojat bazë social-kulturore.³

Koncepti i minimumit jetik i ka fillimet në lashtësinë greke, në studimet mbi mendimin ekonomik⁴. Në vazhdimësi, me zhvillimin e mendimit të ekonomisë politike, ky koncept u bë objekt studimi në shkencat të ndryshme. Prej viteve '90 ka pasur përpjekje për ta zgjaruar konceptin e minimumit jetik duke e sjellë në kornizat e një jetese dinjitoze sikurse është edhe mundësia për të mbuluar nevojat e familjes, të ruajtjes së ndjenjës së vetrespektit ndaj jetës, dhe mundësisë për të marrë pjesë lirisht në jetën sociale e kulturore të vendit përkatës.

¹ Objektivi nr.1 i Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm <https://sdgs.un.org/goals>

² UN Country Report for Albania, 2020.

³ ILO, Akti Nr. 966, 15 Korrik 1999,

http://ilo.org/dyn/normlex/en/f?p=NORMLEXPUB:13100:0::NO::P13100_COMMENT_ID:3081229

⁴ Schulten, Thomas; Müller, Torsten, Living wages – normative und

ökonomischeGründefüreinengemessenenMindestlohn, Artikull i botuar në WSI-Mitteilungen, Tetor 2017, DOI



Në rastin e vendit tonë, pyetja e parë që shtrohet në këtë drejtim është nëse minimumi jetik është normë ligjore apo jo. Në legjislacionin aktual shqiptar ende mungon një dispozitë e posaçme kushtuar minimumit jetik, si për përkufizimin ligjor të tij, ashtu edhe për detyrimin ligjor për llogaritjen e tij. Minimumi jetik ka mbi 25 vjet që është integruar në legjislacionin shqiptar si një parashikim kufizues i mbajtjes së detyrueshme të pagës apo të ardhurave jetike të debitorëve, por pa një përkufizim konkret të këtij termi.

Përcaktimi i parë i rëndësishëm i minimumit jetik në Shqipëri u evidentua në Kodin e Punës së vitit 1995, por me ndryshimet që i janë bërë në vitet në vijim, koncepti i minimumit jetik është hequr. Referencë tjetër është ajo e Vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 119, datë 08.03.2001, "Për një Shtesë Fondi në Buxhetin e Vitit 2001, të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, për Projektin "Minimumi Jetik, Zyrtar". Që prej asaj kohe, ende nuk është përfshirë në kuadrin ligjor detyrimi i përllogaritjes së minimumit jetik dhe nuk janë caktuar institucionet përgjegjëse për vlerësimin e këtij minimumi.

Siç dihet, në Shqipëri, niveli i pensioneve është i vendosur me ligj, ndërsa niveli i pagës minimale, madhësia në vlerë e ndihmës ekonomike, pagesës së papunësisë dhe pagesës së paaftësisë përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. **Asnjëri prej këtyre treguesve të varfërisë nuk bazohet drejtpërdrejt në treguesin e minimumit jetik.** Mungesa e këtij definicioni e bën Shqipërinë pjesë të grupit të atyre vendeve që nuk mund të garantojnë apo sigurojnë në mënyrë efektive burimet e jetesës bazë së qytetarëve.

➔ HISTORIKU I PËRLLOGARITJES SË MINIMUMIT JETIK NË SHQIPËRI

Ecuria e përllogaritjes së minimumit jetik në vendin tonë daton që në vitet e fundit të regjimit komunist (1989), ku u vlerësua që minimumi jetik për familje në muaj ishte në vlerën 450 lekë. Me ndryshimin e sistemit, studimi

i parë për përcaktimin e minimumit jetik është në vitin 1991 nga Ministria e Ekonomisë dhe Instituti i Studimeve të Ekonomisë, në të cilin minimumi jetik rezultoi në vlerën 870 lekë për familje në muaj. Përpjekja e fundit institucionale e kryer për llogaritjen e minimumit jetik është ajo e vitit 2001 të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ku minimumi jetik u përlogarit 7,975 lekë në muaj për frymë. Që prej kësaj periudhe, të vetmet vlerësime institucionale janë ato të realizuara nga INSTAT për kufirin e varfërisë për frymë, i cili u përcaktua në vlerën 4,891 lekë (2002); 5,272 lekë (2005); 5,722 lekë (2008) dhe 6,047 (2012).⁵ Kontribut në këtë fushë kanë dhënë dhe studiues të tjerë të pavarur. Në vitin 1995, studiuesi Luan Shahollari përcaktoi minimumin jetik, sipas të cilit varianti optimal ishte 4,543 lekë në muaj për një familje me katër anëtarë. Sipas profesorit Ilija Telo, minimumi jetik për frymë llogaritej të ishte 9,058 lekë në muaj në vitin 1998. Përlllogaritja e fundit e këtij treguesi u bë në vitin 2011 nga studiuesi Kiço Ziso, i cili e përlllogariti minimumin jetik në nivelin e 15,072 lekëve në muaj për frymë. Diferencat në vlerën e minimumit jetik vijnë si pasojë e këndvështrimeve dhe metodologjive të ndryshme në trajtimin e përlllogaritjes së minimumit jetik.

Minimumi Jetik (në lekë)				
Institucioni	Viti	Për frymë	Për një familje me katër persona	Burimi
ME dhe ISE	1989		450	Referencë e tërthortë
ME dhe ISE	1991		870	Referencë e tërthortë
MPCS	2001	7,975	21,532	Referencë e tërthortë
INSTAT	2002	4,891		LSMS, 2002
INSTAT	2005	5,272		LSMS, 2005
INSTAT	2008	5,722		LSMS, 2008
INSTAT	2012	6,047		LSMS, 2012
L. Shahollari	1995	9,058	4,543; 3,197; 9,058	Instituti i Punës BSPSH
I. Telo	1998	9,058		Instituti i Punës BSPSH
K. Ziso	2011	15,072		Instituti i Punës BSPSH

Burimi: Raporti nga Avokati i Popullit "Llogaritja e Minimumit Jetik në Shqipëri", 2016⁶

⁵ 80 INSTAT, Anкета mbi Nivelin e Standardit të jetesës, Metodologjia,

<http://www.instat.gov.al/en/themes/living-standard.aspx>

⁶ [LLOGARITJA E MINIMUMIT JETIK NË SHQIPËRI.pdf \(avokatipopullit.gov.al\)](#)

Gjatë këtij rrugëtimi është me vlerë të përmendet raporti i vitit 2016, i bërë nga institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me ACER (Albanian Centre for Economic Research), i cili ka vlerësuar se përlogaritja e këtij minimumi, përcaktohet në shumën 16,000 lekë dhe nëpërmjet një analize të thjeshtë krahasimore, vlerësohet se standardi i pagesë minimale, pensionit minimal, ndihmës ekonomike, pagesës së papunësisë dhe pagesës së paaftësisë në vend është më i ulët se niveli i llogaritur i minimumit jetik. Një nga konkluzionet e tij është pikërisht nevoja e përcaktimit me ligj të detyrimit për llogaritjen e minimumit jetik dhe institucionit përgjegjës të ngarkuar me këtë detyrë, dhe reflektimi në legjislacionin i nevojës për indeksimin e këtij treguesi çdo vit. Pavarësisht studimit të kryer në 2016, nga ana institucionale nuk pati asnjë “përgjigje aktive”.

Shqetësimi për këtë çështje është ngritur në nivel debati publik nga institucioni publik i Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili në vitin 2018 ka reaguar me akte dhe komunikime shkresore kundrejt institucioneve të tjera, ku theksohet se mungesa e përcaktimit të termit minimum jetik në legjislacion, ka prekur thellësisht nivelin e jetesës së familjeve me ndihmë ekonomike. Mbi këtë bazë, KLSH-ja ka kërkuar që institucionet të angazhohen për nisjen e një studimi, që do të nxjerrë minimumin jetik zyrtar por duket se nuk ka gjetur gatishmërinë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ku institucioni ka refuzuar duke u shprehur zyrtarisht, se përgjegjësia për këtë studim shkon përtej këtij institucioni.

Pas 5 viteve, Avokati i Popullit e ka risjellur çështjen e minimumit jetik në vëmendje nëpërmjet një raporti të dytë, ku nxjerr një tjetër shifër dhe rekomandime në lidhje me minimumin jetik në Shqipëri. Sipas raportit të fundit nga Avokati i Popullit, metoda e përdorur për të llogaritur Minimumin Jetik në Shqipëri është ajo e njohur si Metoda e Varfërisë Absolute. Sipas kësaj metode llogariten: kufiri i varfërisë ushqimore, dhe kufiri i varfërisë jo-ushqimore. Të dy këto kufinj varfërie llogariten si kosto të nevojave bazike ushqimore dhe jo-ushqimore, dhe kur mbledhen, ato japin kufirin e varfërisë si kërkesa minimale që duhet të plotësohen për të jetuar. Mbledhja e vlerave monetare të këtyre dy kufijve të varfërisë na jep Minimumin Jetik.

	Vlera në %	Lek në muaj
Kufiri i varfërisë ushqimore	41,3	7,427
Kufiri i varfërisë jo-ushqimore	58,7	10,448
Minimumi Jetik për frymë		17,875

Burimi: "Raport për Standartin e Minimumit Jetik në Shqipëri", 2021⁷

Nga tabela e paraqitur më sipër, e siguar gjithashtu nga raporti i Avokatit të Popullit, në lidhje me llogaritjen e minimumit, shohim që studiuesit e raportit kanë dalë në përfundimin se vlera e Minimumit Jetik për vitin 2019 në Shqipëri është përafërsisht **17, 875 Lekë**.

Vlera e përlogaritur nga Avokati i Popullit për Minimumin Jetik në Shqipëri është 9,9 % më e lartë se sa pensioni minimal për zonat urbane, 37,5 % më e lartë se pagesa e papunësisë dhe rreth 3 herë më e lartë se ndihma ekonomike, ndërsa është 45,5 % më e ulët se sa paga minimale.

Sic mund të shohim rrugëtimi i përlogartjes së Minimumit Jetik është i shtrirë në kohë dhe i është alokuar një shifër e caktuar në vite të ndryshme nga studiues dhe burime të ndryshme, megjithatë vazhdojmë të jemi i **vetmi vend në Ballkan dhe Europë që nuk e kemi të vlerësuar zyrtarisht Minimumin jetik.**

Arsyet mbi këtë fakt mund të jenë teknike por edhe politike. Në fund të fundit, politika është ajo që ndërton një agjendë prioritetesh dhe, pavarësisht kostove që kjo agjendë mund të ketë, duhet ndjekur rigorozisht pasi varfëria na përket të gjithëve. Sic mund të shohim edhe nga ecuria e përlogaritjes së Minimumit Jetik në vendin tonë, nuk kanë munguar përpjekjet dhe diskutimet mbi rëndësinë dhe nevojën e përlogaritjes dhe zyrtarizimit.

Diskutimet politike, ndonëse më të rralla, sërish kanë qënë të pranishme por asnjë qeveri deri sot (më shume se 30 vite) nuk e ka realizuar. Nëse do të kishte vullnet politik, zgjidhjet teknike do të ishin të menaxhueshme, edhe pse në dukje shumë të vështira. Shqipëria është vendi me nivelin më të lartë të shtresave të varfëra në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

⁷ RAPORT PËR STANDARDIN E MINIMUMIT JETIK NË SHQIPËRI, 2021, link: [Minimumi jetik ok.pdf \(avokatipopullit.gov.al\)](#)

Sipas Bankës Botërore për vitin 2021, vlerësohet që rreth 31% e popullsisë jeton me të ardhura ditore nën 5.5 USD (të matur me PPP⁸), ndërkohë që tek vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor situata varion midis intervalit 17%-21%. Vendosija e një minimumi jetik zyrtar do të sillte dhe detyrimin ligjor që qeveria të përballet me këtë detyrim kushtetues.

Në kontekstin aktual të financave publike, situata është e vështirë pasi do të ndikonte negativisht në qëndrueshmërinë e financave publike por edhe në nivelin e investimeve publike, këto të fundit shumë të rëndësishme në rritjen ekonomike. Nga ana tjetër, duhet të mendojmë që ekonomia shqiptare ka nivel të lartë informaliteti dhe kjo karakteristikë mund të ndikojë edhe në nënvlerësimin e të ardhurave.

Pra, informaliteti mund të ekzistojë edhe tek ata persona që janë të deklaruar me të ardhura të ulëta ose pa të ardhura. Gjithashtu, gjerësia e madhe e sektorit bujqësor në vend mund të ketë efekte përzmadhuese të vlerësimit të lartë të varfërisë në vend, pasi sektori bujqësor mund të mos raportojë konsumin familjar të produkteve bujqësore dhe blegtorale që nuk tregtohen, por që kryejnë ciklin e ekonomisë familjare. Ky argument nuk duhet të zhvendosë vëmendjen për varfërinë, por janë disa teknikalitete që duhet të merren në konsideratë.

Shpallja e një Minimumi Jetik zyrtar duhet të ndiqet me strategji afatgjata në shumë aspekte. E para, në burimet e nevojshme financiare që për momentin janë të pamjaftueshme. E dyta, në mekanizmat institucionalë që do të përdoren për të asistuar personat me Minimum Jetik. E treta, koordinimi institucional dhe politik do të ndikojë që personat të dalin nga Minimum Jetik dhe të riaftësohen në tregun e punës nëpërmjet zhvillimit të kapitalit njerëzor, duke u aksesuar në arsim dhe shëndetësi. Disa instrumenta teknike që mund të përdoren janë kreditë sociale, biznesi social, personat me aftësi të kufizuara që mund të kenë trajtim specifik në tregun e punës, etj.

⁸ Matja me PPP dallon nga matja me vlerën korente. Për te kuptuar dallimin, PBB për frymë për vitin 2020 për Shqipërinë, sipas Bankes Botërore është rreth 5.246 USD, ndërkohë me PPP (vit bazë 2017) është rreth 13.192 USD.

➔ SITUATA AKTUALE E VARFËRISË NË SHQIPËRI

Një ndër diskutimet dhe problemet e sotme të politikës ekonomike në mbarë botën lidhet me hendekun që po thellohet midis të pasurve dhe të varfërve. Rritja ekonomike në dekadën e fundit nuk po ndikon në shtimin e mirëqenies së popullatës në vend. Të ardhurat shtesë që kanë gjeneruar të gjitha burimet janë përqendruar në pak përfitues, duke e thelluar pabarazinë e duke ndikuar për më keq shtresat e varfra në vend, të cilat rrezikojnë të rriten në numër.


Nëse shmangim realitetin e përditshëm dhe përqendrohemi vetëm në shifrat dhe përfundimet e ndryshme të studimeve dhe raporteve kombëtare dhe ndërkombëtare, arrijmë të kuptojmë që situata e varfërisë dhe standarti i jetesës në vendin tonë shfaqet në vështirësi të konsiderueshme.

- Në Shqipëri, rreth 40% e popullatës jeton me 5.5 \$ në ditë dhe krahasuar me vendet e tjera në rajon si Serbia, Maqedonia, Bosnja-Hercegovina, Mali i Zi, Kosova, ky është niveli më i lartë i shtrirjes së varfërisë (World Development Indicators, 2018)⁹.
- Grupet që janë më të disavantazuara dhe jetojnë në varfëri janë: i) të rinjtë e moshës 15-24 vjeç, një pjesë e madhe e tyre janë të pa përfshirë në arsim, punë apo kualifikim profesional (World Development Indicators, 2018¹⁰) dhe ii) fëmijët, sipas raportit të UNICEF për mirëqënien e fëmijëve, 19.2% e familjeve me fëmijë jetojnë në varfëri absolute (UNICEF, 2016).
- Disa karakteristika të përbashkëta shoqërojnë familjet që jetojnë në varfëri, të tilla si: arsimimi i ulët i kryefamiljarit/es, papunësia e kryefamiljarit/es; numri i madh i anëtarëve të familjes (HBS, 2016).
- Familjet me fëmijë 0-5 vjeç dhe me fëmijë adoleshentë ndodhen në fashën më të ulët të varfërisë absolute, që do të thotë se këto grupe janë shumë të cënueshme nga varfëria.

⁹ World Development Indicators, World Bank aksesuar online në: <http://datatopics.worldbank.org/worlddevelopment-indicators/>

¹⁰ World Development Indicators, World Bank aksesuar online në: <http://datatopics.worldbank.org/worlddevelopment-indicators/>

- Sipas studimit për Transfertat e Mbrojtjes Sociale drejt Familjeve të Varfëra (UNICEF, 2019¹¹), ku janë listuar kategoritë e shpenzimeve për familjet e varfëra, ushqimi zë pjesën më të madhe të shpenzimeve (rreth 96%) pa lënë asnjë hapësirë për shpenzime për aktivitete të zhvillimit njerëzor si shëndeti apo edukimi, si dhe aktivitete të tjera zhvilluese dhe kulturore.



Tërmeti i 26 Nëntorit 2019 dhe pandemia kanë patur efekte negative të rëndësishme mbi ekonominë shqiptare. Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)¹² dhe Banka Botërore (BB)¹³ parashikuan një recesion prej 8.5% në 2020, ndërsa rritja ekonomike parashikohet të jetë e moderuar në 5% për 2021 dhe 3.9% në 2022. Nga ana tjetër FMN-ja¹⁴ ka observuar se ekonomisë shqiptare i kanë munguar investimet pro-ritjes nga burime publike, ndërsa vendi ka një nivel të ulët të investimeve të huaja direkte në ekonomi. Situata ekonomike në vendet e Bashkimit Europian gjithashtu pritet të ndikojë në aftësinë e ekonomisë shqiptare për t'u rimëkëmbur në vitet në vijim, kjo për arsye të ekspozimit të lartë që ka vendi ndaj ekonomive të BE-së, sidomos atyre italiane dhe greke.

Një situatë e tillë makroekonomike, e brendshme dhe e jashtme, pritet të ngadalësojë të gjithë treguesit që lidhen nivelin e jetesës, punësimin, të ardhurat si dhe të rrisë nevojat për të siguruar një minimum të ardhurash për shtresat e varfëra në nevojë. Edhe pse pritet që në periudhën afatmesme numri i njerëzve të varfër të shtohet, sikundër dhe numri i personave në rrezik për të rënë në varfëri, Shqipëria vijon të mos ketë një qasje zyrtare ndaj minimumit jetik.

¹¹ UNICEF 2019, Zlatko, N. Mapping Social Protections transfers to poor households in Albania aksesuar online në: <https://www.unicef.org/albania/media/3161/file/Mapping%20Social%20Protection%20Transfers.pdf>

¹² Deklarata e FMN aksesuar online në: <https://www.imf.org/en/News/SearchNews#sort=%40imfdate%20descending>

¹³ World Bank Western Balkans Regular Economic Report Update Fall 2020, aksesuar online në: <https://www.worldbank.org/en/region/eca/publication/western-balkans-regular-economic-report>

¹⁴ IMF Mission statement November 26th 2019, aksesuar online në: <https://www.imf.org/en/News/Articles/2019/11/26/mcs11262019-albania-staff-concluding-statement-of-the-2019-article-iv-mission>

Për sa i përket sigurimit të një minimumi jetik është shteti ai që duhet t'i garantojë individëve një nivel minimal të standardit të jetesës. Në një situatë të tillë komplekse ku varfëria është një kërcënim i vazhdueshëm për qytetarët shqiptarë, diskutimi i përlogaritjes së minimumit jetik ka një rëndësi të veçantë. Minimumi jetik shërben si një udhëzues për politika efektive të qeverisë pasi:

1. Tregon dinamikën e ndryshimeve në standardin e jetesës së individëve.
2. Ndihmon për të përcaktuar normën minimale të pensioneve, ndihmës ekonomike, pagesës së papunësisë, pagesës së paaftësisë dhe numrin e përfituesve për secilën prej tyre.
3. Tregon mënyrat për të orientuar pagën minimale drejt nivelit të minimumit jetik për një të punësuar.
4. Ndihmon për të përcaktuar përjashtimin nga taksa mbi te ardhurat nën minimumin jetik ose limitin e përjashtimit nga taksa e të ardhurave.

➔ POLITIKAT EKZISTUESE PËR MBROJTJEN SOCIALE

Politikat për mbrojtjen sociale në Shqipëri mbështeten në objektivat sociale që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka njohur si detyra të shtetit për t'i siguruar çdo qytetari shqiptar, pavarësisht të ardhurave, origjinës, moshës, gjinisë, etnisë, edukimit, orientimit seksual, identitetit kulturor, bindjeve politike apo fetare, jetë dinjitoze dhe shërbime publike cilësore sa i përket sigurimit të ushqimit të nevojshëm, strehimit, shëndetit dhe arsimimit. Një nga dokumentat kryesore që qeveria shqiptare ka mbështetur ndërhyrjet e saj për zbutjen e varfërisë është Axhenda 2030 e Kombeve të Bashkuara dhe Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm, ku një prej elementëve më të rëndësishëm të Qëllimit 1 për Zhvillimin e Qëndrueshëm është arritja e mbrojtjes sociale të qëndrueshme për këdo, me fokus të varfërit dhe grupet e cënueshme.

Politikat kryesore për mbrojtjen sociale janë: a) ndihma ekonomike; b) pagesa për Aftësinë e Kufizuar dhe c) shërbimet e përkujdesit shoqëror. Strategjitë për mbrojtjen sociale përfshijnë kombinimin e politikave të mbrojtjes sociale me ato të përfshirjes sociale dhe të politikave aktive të punësimit. Gjithashtu, politikat e mbrojtjes sociale ndikojnë dhe ndikohen nga politikat e punësimit dhe

sigurimeve shoqërore. Norma ligjore e minimumit jetik ka karakteristika të ngjashme me kategori të tjera të parashikuara nga legjislacioni shqiptar, sikurse janë, **“paga e paprekshme”, “paga minimale”, dhe “ndihma ekonomike”**.

Viti	Pensioni		Pagesa e papunësisë	Ndihma ekonomike	Paga Minimale
	Urban	Rural			
2018	15875	8792	12000	5084	26000
2019	16254	9165	13000	5154	26000
2020	15.732	9.295	13000	5154	30000

Burimi: INSTAT

Pa u thelluar dhe përhumbur në teknalitete të pafundme të “paketës së mbrojtjes sociale”, le ti referohemi tabelës së mësipërme, e cila ofron një përshkrim të plotë të dinamikës së pagës minimale, pensionit minimal, ndihmës ekonomike dhe pagesës së papunësisë ndër vite. Ndonëse ende nuk ka të dhëna zyrtare sa i takon minimumit jetik në Shqipëri, arrihet të dallohet lehtësisht se këto tregues luhaten nën nivelin “e pranueshëm” të minimumit jetik.

Natyrshëm lind pyetja se sa efektive janë paketat aktuale të ndihmës sociale në Shqipëri.

Ndihma ekonomike në vite ka pasur problematikat e saj, ku janë identifikuar raste kur persona me mundësi të larta financiare dhe ekonomike ishin pjesë e listave të ndihmës ekonomike, që tregojnë për abuzimin në këtë drejtim. Gjithashtu, në disa raste, persona që asistohen me ndihmë ekonomike mund të ulin nxitësat në dy drejtimet kryesore: e para, për tu kthyer në tregun e punës dhe e dyta mund të ulin nevojën për krijimtarinë novatore në procese të ndryshme.


Gjithsesi, kur lexon kriteret për përfitim të ndihmës ekonomike, duken përgjithësisht përfaqësuese për klasifikimin e individit, si dhe në nxitësat që kërkohen të përftohen prej saj. Aktualisht ndihma ekonomike menaxhohet nga qeverisja vendore. Bazuar në referencat ligjore, bashkitë trajtojnë kërkesat për ndihmë ekonomike dhe më pas, me miratim të strukturave hierarkike vendore, personat futen në skemën e listës së ndihmës ekonomike.

Megjithatë, ka një aspekt shumë domethënës që duhet adresuar me vemendje. Përveç paaftësisë për të punuar dhe pamundësisë për të realizuar të ardhura, duhet adresuar më mirë edhe pasuria që zotërojnë këto individë apo persona të lidhur me ta. Mbetet e paqartë aftësia e strukturave vendore për të përcaktuar me saktësi pronat e patundshme (kryesisht në apartamente) të subjekteve që aplikojnë apo asistohen me ndihmë ekonomike, lidhur edhe me problematikën historike të pronës në Shqipëri. Në aspektin monetar, ndihma ekonomike duket e pamjaftueshme për të dhënë shanse të barabarta për shtresat në nevojë, dhe kjo duhet pasur gjithmonë parasysh.

Dilema më e madhe lidhet me hapat konkretë që duhet të ndjekë Shqipëria për llogaritjen dhe zyrtarizimin e një minimumi jetik në mënyrë që të jetë sa më efektiv dhe i dobishëm.

Nëse i referohemi nismave të ndërmarra nga qeveria për vitin 2022, me rritjen e fondit për ndihmën ekonomike, mund të pritet një impakt pozitiv në mbeshtetjen e shtresave në nevojë, por ky zhvillim nuk është zyrtarizim i minimumit jetik. Pa zgjidhur problematikën si: korrupsioni, keqqeverisja, klientelizmi politik, mungesa e konkurrencës së drejtë në tregje nuk mund të zgjidhim problemin e varfërisë. Pa zgjidhur këto problematika që prekin çdo aspekt të shoqërisë, nuk mund të ketë politika efektive. Mund të ketë politika të mirë hartuara, por në efektin e faktorëve të sipërpërmendur, efektiviteti i çdo politike është ekstremisht i rrezikuar.

➔ Gjetjet kryesore



Të dhënat tregojnë që megjithëse varfëria relative ka ardhur në ulje të pakonsiderueshme nga 23.7 (në vitet 2017-2018) në 23.4 në vitin 2018, përqindja e popullatës që janë në rrezik varfërie ose jetojnë me të ardhura shumë të ulëta është 49%, që do të thotë se pothuajse gjysma e popullsisë jetojnë në kushte shumë të vështira ekonomike.

Në legjislacionin aktual shqiptar ende mungon një dispozitë e posaçme kushtuar minimumit jetik, si për përkufizimin ligjor të tij, ashtu edhe për detyrimin ligjor për llogaritjen e tij, duke na bërë të jemi i vetmi vend në Ballkan dhe Europë që nuk e kemi të vlerësuar zyrtarisht Minimumin jetik.



Në Shqipëri, niveli i pensioneve është i vendosur me ligj, ndërsa niveli i pagës minimale, madhësia në vlerë e ndihmës ekonomike, pagesës së papunësisë dhe pagesës së paaftësisë përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. **Asnjëri prej këtyre treguesve të varfërisë nuk bazohet drejtpërdrejt në treguesin e minimumit jetik.** Mungesa e këtij definicioni e bën Shqipërinë pjesë të grupit të atyre vendeve që nuk mund të garantojnë apo sigurojnë në mënyrë efektive burimet e jetesës bazë së qytetarëve.



Nga raporti i Avokatit të Popullit, në lidhje me llogaritjen e minimumit, shohim që studiuesit kanë dalë në përfundimin se vlera e Minimumit Jetik për vitin 2019 në Shqipëri është përafërsisht **17,875 Lekë. Kjo vlerë është 9,9 % më e lartë se sa pensioni minimal për zonat urbane, 37,5 % më e lartë se pagesa e papunësisë dhe rreth 3 herë më e lartë se ndihma ekonomike, ndërsa është 45,5 % më e ulët se sa paga minimale.**



Sipas Bankës Botërore për vitin 2021, vlerësohet që rreth 31% e popullsisë jeton me të ardhura ditore nën 5.5 USD (të matur me PPP), ndërkohë që tek vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor situata varion midis intervalit 17%-21%. Vendosja e një minimumi jetik zyrtar do të sillte dhe detyrimin ligjor që qeveria të përballet me këtë detyrim kushtetues.

→ Rekomandime



Shpallja e një Minimumi Jetik zyrtar duhet të ndiqet me strategji afatgjata në shumë aspekte: **E para**, në burimet e nevojshme financiare që për momentin janë të pamjaftueshme. **E dyta**, në mekanizmat institucionalë që do të përdoren për të asistuar personat me Minimum Jetik. **E treta**, koordinimi institucional dhe politik do të ndikojë që personat të dalin nga Minimum Jetik dhe të riaftësohen në tregun e punës nëpërmjet zhvillimit të kapitalit njerëzor, duke u aksesuar në arsim dhe shëndetësi.



Disa instrumenta teknike që mund të përdoren janë kreditë sociale, biznesi social, personat me aftësi të kufizuara që mund të kenë trajtim specifik në tregun e punës, etj.



Nëse i referohemi nismave të ndërmarra nga qeveria për vitin 2022, me rritjen e fondit për ndihmën ekonomike, mund të pritet një impakt pozitiv në mbeshtetjen e shtresave në nevojë, por ky zhvillim nuk është zyrtarizim i minimumit jetik. Pa zgjidhur problematikat si: *korupsioni, keq-qeverisja, klientelizmi politik, mungesa e konkurrencës së drejtë në tregje* nuk mund të zgjidhim problemet e varfërisë.

Pa zgjidhur këto problematika që prekin cdo aspekt të shoqërisë, nuk mund të ketë politika efektive. Mund të ketë politika të mirë hartuara, por në efektin e faktorëve të sipërpërmendur, efektiviteti i cdo politike është ekstremisht i rrezikuar.

#QËNDRESË/MIRËQEVERISJE

Ky raport publikohet në kuadër të nismës së Qëndresës Qytetare për të nxitur transparencën dhe përgjegjshmërinë e qeverisë me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED)

Analistët e rinj të politikave publike të angazhuar në këtë nismë do të prodhojnë raporte monitoruese periodike në fushat kryesore të qeverisjes dhe do të angazhohen në përpjekje për avokim me zyrtarë të shtetit, ligjvënësit, ekspertë dhe shoqërinë civile për të promovuar rekomandime që do të rrisin transparencën dhe përgjegjshmërinë e zyrtarëve dhe qeverisë.

Mendimet dhe opinionet e shprehura në këtë raport i përkasin autorit realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e National Endowment for Democracy (NED) dhe Qëndresës Qytetare.